



**SBASHK**

**Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

# Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

*Ë-buletin*

*Gusht, 2015*

SBASHK-u vazhdon me takimet për dialog social  
**Angazhime për realizimin e detyrave nga Plani strategjik**



Duke realizuar agjendën e aktiviteteve në bazë të programit për vitin 2015, SBASHK-u organizoi në Durrës një punëtori disa ditore me anëtarët e Këshillit Drejtues, që përfaqësojnë të punësuarit në arsimin e Kosovës. Kryesia pa të udhës që në këtë punëtori të zhvillohen disa seanca pune duke veçuar çështje me rëndësi që lidhen me aktivitetet dhe ... (faqe 8)

SBASHK dhe Sindikatat Shqiptare të Arsimit forcojnë bashkëpunimin  
**SBASHK, FSASH dhe SPASH takohen në Durrës**



Një pjesë e punëtorisë së mbajtur me Këshillin Drejtues i është kushtuar edhe analizës dhe këmbimit të përvojave ... (faqe 5)

SBASHK-u vazhdon bashkëpunimin me GIZ-in  
**Bashkërisht për ngritjen e cilësisë në arsim**



Çdoherë kur është në pyetje ngritja e cilësisë në arsim, SBASHK-u është i gatshëm të jap më të mirën e mundshme në këtë drejtim... (faqe 6)

Përshtypjet e 370 punonjësve të arsimit që pushuan në Shqipëri  
**SBASHK-u ndihet shumë mirë kur lexon fjalë të mira**

Pasi që nuk kemi pasur hapësirë të mjaftueshme në numrat e kaluar për t'i shprehur të gjitha përshtypjet e 370 punonjësve....(faqe 7)

Intervistë me z.Nevrus Kaptelli, Kryetar i SPASH-Shqipëri  
**Do t'a forcojmë bashkëpunimin me SBASHK-un**

Nevrus Kaptelli në Kongresin 6-të të SPASH-it u zgjodh President. Ka një përvojë të shkëlqyer në angazhimet dhe veprimtaritë ... (faqe 3)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE  
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center  
Qendra për Arsim e Kosovës

**KEC**



## Editorial

### Borxhi ndaj viteve të mëdha të arsimit



Po nisim edhe një vit shkollor. Thuhet se në përgjithësi janë bërë përgatitjet dhe zilja do të thërras fëmijët tanë të rikthehen për të shtuar dituritë. Duke bërë një analizë konkrete e pa emocione vërehet qartë se qeveritë lokale nëpër komuna dhe Qeveria qendrore duhet të shtojnë angazhimet për të realizuar obligimet karshi Kontratës Kolektive. Duhet zgjidhur drejt

çështjen e kompensimit 70 % të çmimit të biletave të udhëtimit. Duhet zgjedhur edhe çështjen e tri pagave për të punësuarit në arsim me rastin e pensionimit të tyre.

Edhe më shumë nga këto institucionet e Kosovës duhet të marrin punën seriozisht dhe të vënë në jetë në tërësi Ligjin mbi skemat pensionale të financuara nga shteti dhe të njohin edhe në praktikë si kontributdhënëse vitet 90-99. Po ashtu MASHT dhe Qeveria dhe Parlamenti të angazhohen më shumë për të nxjerr e aprovuar Ligjin për statutin e të punësuarve në arsimin shqip të viteve 1990-1999. Ky është borxhi jo i vetëm i institucioneve ndaj viteve të mëdha të arsimit shqip në Kosovë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK-KEC "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", SBASHK-u nga **1 marsi 2015** ofron shërbime juridike për anëtarët e vet.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**

përfaqëson rreth 19.000 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



Implemented by:



Kosovo Education Center  
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Projekti i financuar nga BE  
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

*Intervistë me z.Nevrus Kaptelli, kryetar i SPASH-Shqipëri*

### Do t'a forcojmë bashkëpunimin me SBASHK-un



Nevrus Kaptelli në Kongresin 6-të të SPASH-it (Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë) u zgjodh President. Ka një përvojë të shkëlqyer në angazhimet dhe veprimtaritë sindikale në arsimin shqiptar.

Ka qenë pjesëmarrës aktivë në shumë veprimtari sindikale në Shqipëri, por edhe në vende të ndryshme. Ka dhënë kontribut të lartë edhe në shtimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit mes Sindikatave të Arsimit Shqiptar dhe SBASHK-ut.

#### 1. Kush është Nevrus Kaptelli?

Kaptelli:

Nevrus Kaptelli, është i datëlindjes 5 prill 1965, ka lindur ne Gramsh dhe banon ne Tiranë. Ka mbaruar arsimin e lartë për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, ka shkallën e parë të kualifikimit, titullin “Mësues Mjeshtër”, ka punuar si mësues në arsimin e mesëm, disa vite si nëndrejtor në gjimnaze dhe drejtor. Nismëtar i lëvizjeve të proceseve demokratike të viteve 1990, ku ka dhënë një kontribut të shquar në ngritjen, organizimin dhe funksionimin e sindikatave te pavarura në rrethin e Gramshit. Drejtues i grevës së përgjithshme të vitit 1991 në rrethin e Gramshit dhe Kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Rrethit nga fillimi e deri më sot. Në prill-maj 1996 ka kryer kursin e plotë për lektor të shkollës sindikaliste shqiptare pranë sindikatës SID në Danimarke, ku është vlerësuar me rezultate shumë të mira. Me hapjen e shkollës së përbashkët sindikale BSPSH-KSSH e deri në përfundim të saj ka qenë lektor i jashtëm dhe ka drejtuar e zhvilluar disa trajnime me sindikalistë të të dy sindikatave. Në vitet 2003-2006 ka qenë

Koordinator i rrjetit SELEN për Shqipërinë (Rrjeti i Edukatorëve të Punës të Evropës Juglindore) Në vitin 2008, me hapjen e shkollës sindikale të BSPSH emërohet lektor në departamentin e Edukimit të BSPSH-së dhe njëkohësisht ka punuar me kohë jo të plotë edhe si Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun në SPASH.

Është anëtar i sekretariatit të BSPSH. Me rastin e 20-Vjetorit, emri i tij është vendosur në librin e nderit të BSPSH.

Si Kryetar i BSPSH të rrethit Gramsh dhe anëtar i Këshillit Kombëtar ka marrë pjesë në të gjitha kongreset e BSPSH dhe 4 kongrese të SPASH. Nga shtatori 2009 deri në tetor 2013 (në Kongresin e 6-të) ka punuar si Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun në SPASH.

Mbështetur në nenin 16 të statutit të SPASH, si anëtar i Këshillit Kombëtar, pas propozimeve të konferencave të SPA të disa rretheve, Këshilli Kombëtar i SPASH, në mbledhjen e tij të datës 20 tetor 2013 vendosi që njëra nga kandidaturat për president të SPASH në Kongresin e VI të jetë z.Nevrus Kaptelli. Ne vlerësim të punës, përkushtimit dhe aftësive të tij drejtuese, Kongresi i 6-të e zgjodhi President të SPASH ( Më 26 tetor 2013)

#### 2. Çfarë ka zhvilluar këtë vit ndryshe nga vitet tjera SPASH-i?

Kaptelli:

Viti i ri shkollor që pritet të fillojë mw 14 shtator 2015, SPASH-in e gjen për herë të parë pa Kontratë Kolektive të Punës. Kontrata e fundit kolektive ka përfunduar me 31 dhjetor 2014 dhe që atëherë e deri me sot të gjithë punëmarrësit në arsim janë pa kontrate kolektive, kjo vetëm për zvarritje nga ana e MAS, pasi dy sindikatat SPASH dhe FSASH prej kohësh kanë depozituar në MAS gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku vërtetohet se janë sindikatat me përfaqësues në vend me më shumë se 80% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Arsimin Parauniversitar.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE  
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center  
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



## 3. Situata e arsimit në Shqipëri?

### Kaptelli:

Arsimi në Shqipëri, me gjithë përpjekjet e bëra nga Qeveria ka ende për të arritur në nivelet dhe standardet që e kërkon koha. Reformat e ndërmarra për rritjen e cilësisë në arsim lenë për të dëshiruar për arsye të moszbatimit në tërësi të Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe mos përfshirjen nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) të mendimit të sindikatave. Cilësia në arsim rritet kur në drejtim të shkollave vendosen më të aftët, por fatkeqësisht në shumë raste nuk është zbatuar ligji në këtë drejtim dhe janë vendosur drejtues shkollash që nuk plotësojnë as kriteret ligjore. Mësuesit janë të pasigurt në vendet e tyre të punës nga mungesa e zbatimit të ligjit, por edhe nga mungesa e kontratës kolektive të punës. Gjatë dy viteve të fundit, mësuesve jo vetëm që nuk u është rritur paga, por nuk është bërë as indeksimi i inflacionit. Me gjithë kërkesat dhe protestat e sindikatave të arsimit SPASH dhe FSASH për zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë mësuesit duket se partneriteti dhe dialogu me MAS nuk është në nivelin që kërkohet dhe për këtë përgjegjëse është MAS. SPASH do të punojë me këmbëngulje për të mbrojtur të drejtat e mësuesve.

## 4. Bashkëpunimi SPASH-SBASHK?

### Kaptelli:

SPASH dhe SBASHK kanë një histori të hershme bashkëpunimi. Unë e kam thënë edhe më përpara që ne kemi gjetur një rrugë të ndërtuar qysh në fillimet e lëvizjeve sindikaliste nga Agim Hyseni, Bajram Kruja e Ali Shabanaj, të cilën duhet të punojmë për ta zgjeruar e për ta shndërruar në “autostradë” të bashkëpunimit, jo vetëm për zgjidhjen e problemeve tona të përbashkëta, por edhe për aktivitete të ndryshme ndërmjet sindikatave tona. Në fakt këto nuk kanë munguar, por mundësitë janë për më shumë. Në një takim të tillë të përbashkët të zhvilluar para disa ditësh në Durrës një sindikalist nga Kosova me të drejtë më pyeti: - Pse nuk solidarizoheni edhe ju me protesta ose grevë për realizimit e kërkesave tona ndaj qeverisë? Shqetësimi i tij ishte i drejtë, ligji na e lejon një gjë të tillë, ligji e njeh edhe grevën e solidaritetit, na ngelet vetëm më tepër angazhim për të mbështetur njëri-

tjetrin në zgjidhjen e problemeve, atëherë sindikatat tona do të jenë ato që kërkojnë vetë mësuesit dhe unë besoj se mund dhe duhet ta arrijmë këtë. Ne kemi një marrëveshje të përbashkët midis sindikatave tona SPASH-FSASH dhe SBASHK, e cila duhet riparë me tendencë zgjerimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të përbashkëta duke filluar nga niveli i sindikatave në bazë shkollash, komunash (bashkishë) rajonesh e më gjerë. Dëshira e palëve ekziston, duhet vetëm më shumë realizim praktik dhe unë jam i bindur që bashkëpunimi do vijë në rritje.

## 5. Roli i femrës në udhëheqjen sindikale në Shqipëri?

### Kaptelli:

Sa i përket rolit të femrës në udhëheqjen sindikale në Shqipëri, vazhdimisht ka ardhur në rritje, por ende është larg asaj që duhet të jetë, sepse femrat janë më shumë në arsim dhe normalisht duhet të ishin më shumë edhe në udhëheqjen sindikale, ne do të punojmë që numri i tyre në udhëheqjen sindikale të jetë gjithnjë në rritje. Nuk është normale por ndodh që edhe në një shkollë ku shumica e mësuesve janë femra dhe 3-4 meshkuj, vetë ato zgjedhin drejtues sindikate njërin prej tyre, ndoshta kjo ndodh ngaqë nuk është e lehtë të mbrosh interesat e të tjerëve, por duhet që vetë ato të marrin më shumë përgjegjësi, natyrisht duke i mbështetur edhe ne. Unë besoj që në të ardhmen ato do të përbejnë shumicën në udhëheqjen sindikale, sepse u takon dhe kanë aftësi për këtë.

## 6. Po të ishit në organet udhëheqëse të SBASHK-ut, për çfarë do të angazhoheshit më shumë?

### Kaptelli:

Unë mendoj se udhëheqja e SBASHK-ut, për aq sa unë jam i informuar, është në nivelin e duhur, edhe në një takim që kam pasur me afro 40 prej drejtuesve të SBASHK në Durrës më datë 26.08.2015 kam theksuar se ne duhet të punojmë për të forcuar sindikatën në nivel shkolle, duke nxitur mësuesit që të zgjedhin drejtues sindikate më të mirët prej tyre. Duke zgjedhur më të mirët në çdo shkollë në drejtim të sindikatës vetë sindikata do të jetë më e fortë dhe do të mbrohen më mirë interesat e mësuesve.

## 7. Cili është mesazhi juaj për mësimdhënësit kosovar dhe posaçërisht për anëtarët e SBASHK-ut?

### Kaptelli:

Ju uroj të gjithë mësuesve të Kosovës të kenë një vit të ri shkollor të mbarë dhe me rezultate sa më të larta në

procesin mësimor dhe edukativ, duke forcuar radhët rreth SBASHK-ut për të mbrojtur më mirë veten e tyre, për kushte pune më të mira, për të rritur mirëqenien në familjet e tyre dhe në gjithë Kosovën.

Ju faleminderit SBASHK-ut!

## Gjatë muajit

### Trajnimet për dialog social do të vazhdojnë Njohuritë e fituara do të bartën te kolegët nëpër shkollat e Kosovës

Në kuadër të projektit “*Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore*”- po vazhdohet edhe me dy seminare për komuna të caktuara. Pas Mitrovicës, Vushtrrisë, Pejës dhe Gjakovës, në këtë aktivitet KEC ka paraparë të angazhojë kryetarë shoqatash nga Prishtina dhe më vonë nga Prizreni dhe Ferizaji.

Trajnerët e licencuar do t’u ofrojnë njohuritë e tyre tek pjesëmarrësit me qëllim që ata të bëhen kuadro të suksesshëm për dialog social dhe që njohuritë e fituara, t’i bartin te kolegët e tyre në shkollat ku punojnë. Është edhe ky një shembull i mirë në përpjekje për ta fuqizuar dialogun social në nivelin lokal të organizimit të SBASHK-ut.

### SBASHK dhe Sindikatat Shqiptare të Arsimit forcojnë bashkëpunimin SBASHK, FSASH dhe SPASH takohen në Durrës

Një pjesë e punëtorisë së mbajtur me Këshillin Drejtues i është kushtuar edhe analizës dhe këmbimit të përvojave me SBASHK-ut dhe Sindikatave Shqiptare të Arsimit. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka falënderuar Sindikatat Shqiptare të Arsimit për përkrahjen dhe është shprehur i gatshëm që të shtohet bashkëpunimi në shërbim të anëtarësisë dhe të arsimit në të dy shtetet.

Edhe në këto takime është përsëritur qëndrimi se SBASHK-u do t’i jep gjithmonë përparësi dialogut, por duke mos përjashtuar edhe veprimet sindikale nëse nuk mbesin mundësi tjera në përpjekjet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Për të bërë një vlerësim të arritjeve dhe për të parë se sa po realizohet Plani strategjik i SBASHK-ut dhe cilat janë detyrat konkrete të kësaj sindikate në realizimin e detyrave konkrete në shërbim të anëtarësisë, u organizua kjo punëtori me



Këshillin Drejtues. Pjesë e këtij aktiviteti janë bërë edhe kryetarët e Sindikatave Shqiptare të Arsimit Xhafer Dobrushit dhe Nevruz Kaptelli. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka falënderuar Sindikatat Shqiptare të Arsimit për përkrahjen dhe është shprehur i gatshëm që të shtohet bashkëpunimi në shërbim të anëtarësisë dhe të arsimit në të dy shtetet.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE  
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center  
Qendra për Arsime dhe Kulturë

KEC





Kryetarët Xhafer Dobrushit e Nevruz Kaptelli në emër të anëtarësisë së sindikatave shqiptare kanë përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet. Ata pas kësaj kanë treguar për aktualitetin në arsimin shqiptar duke u ndalur në momentin aktual dhe në sfidën e madhe rreth Kontratës Kolektive për të cilën shteti shqiptar ka hezitime për ta nënshkruar. Dobrushit

e Kaptelli janë shprehur se do të vazhdojnë me angazhimet dhe me përpjekjet në shërbim të anëtarësisë dhe në përpjekjet për të shtuar cilësinë në arsim. SBASHK dhe Sindikatat Shqiptare të Arsimit janë shprehur se duhet shtuar bashkëpunimin përmes takimeve të vazhdueshme të Kryesive dhe organeve tjera sindikale. Kjo punëtori ka nxjerr detyra konkrete për nivelin lokal e qendror të SBASHK të cilat do të realizohen sipas dinamikës së paraparë. Edhe në këto takime është përsëritur qëndrimi se SBASHK-u do t'i jep gjithmonë përparësi dialogut, por duke mos përjashtuar edhe veprimet sindikale nëse nuk mbesin mundësi tjera në përpjekjet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. SBASHK dhe Sindikatat Shqiptare të Arsimit janë shprehur se duhet shtuar bashkëpunimin përmes takimeve të vazhdueshme të Kryesive dhe organeve tjera sindikale.

## SBASHK-u vazhdon bashkëpunimin me GIZ-in Bashkërisht për ngritjen e cilësisë në arsim



Çdoherë kur është në pyetje ngritja e cilësisë në arsim, SBASHK-u është i gatshëm të jap më të mirën e mundshme në këtë drejtim. Në bazë të shembullit të mirë të bashkëpunimit me GIZ dhe për gjithë angazhimet dhe punën që ata po bëjnë për të ndihmuar e përkrahur ngritjen e cilësisë në arsimin e Kosovës, kësaj radhe me ndihmën e tyre kemi arritur që të kemi për secilën shkollë nga një poster dhe fletëpalosje me përmbajtje promovuese të përpjekjeve për ngritjen e cilësisë në arsim, të cilat do të shpërndahen për çdo shkollë në 30 takimet e parapara në shtator 2015 nëpër komunitet e Kosovës me mësimdhënës dhe veprimtarë

sindikale. Këto materiale promovuese do të japin sqarimin rreth 40 orëve punë në javë për mësimdhënësit, ku 20 orë janë mësimore për mësimdhënie, 15 orë përgatitje dhe 5 orë aktivitete me prindër. SBASHK edhe njëherë po dëshmon se krahas



gjithë angazhimeve për realizimin e kërkesave të anëtarësisë është angazhuar gjithmonë edhe në ngritjen e cilësisë dhe në përmirësimin e kushteve të punës arsimore në shkollat tona.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE  
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center  
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



**Përshtypjet e 370 punonjësve të arsimit që pushuan në Shqipëri  
SBASHK-u ndihet shumë mirë kur lexon fjalë të mira**

Pasi që nuk kemi pasur hapësirë të mjaftueshme në numrat e kaluar për t'i shprehur të gjitha përshtypjet e 370 punonjësve të arsimit që pushuan në Durrës, për hir të korrekhtësisë ndaj tyre, një pjese të mendimeve të thëna dhe të shkruara sinqerisht nga ata, po i publikojmë në këtë numër të gazetës elektronike.

Z. Nazmi Krasniqi nga shkolla “Gjon Serreqi ”-  
Ferizaj jep përshtypjet se si këto ditë ishin të  
mrekullueshme sa i përket organizimit dhe çdo tjetër  
që kishte të bënte në këtë pushim:

Po ashtu edhe kolegu nga Mitrovica, z.Sinan Shala, tha se vlen të përmendet se gjatë këtyre ditëve, patëm mundësinë të njihemi me shumë kolegë si dhe shkëmbyem mendime rreth punës tonë edukativo-arsimore.

[illegible]

3451, "Hosan Puskhina"  
 na Mitrovica  
 Prestidigja ime prvo prestidigjan  
 i doktor te organizirao njez 5385HK u  
 kolite tepu, e misli me gde prikupljanje  
 njez organizirani i udjelomant i  
 cili kolite me gde virent, prestidigjan  
 te aritviti me kolite BONTA prefa  
 istite e kolite gjeostimasi: nolađa e  
 dlamaree, gadaree, vendarose stane  
 e dnyet gra esuzi problemu prestidigjan  
 shetirime kolite sheme te asuzi  
 vi: ustipirni, bujgova, argelini ofi.  
 Vlas te perundiget se gpat kolite  
 kolite u vijebrani me shane kolite  
 vi dbe shetirime me shane kolite  
 puniti kolite kolite kolite kolite  
 Dostigjan me te aritviti sa ma  
 shane puniti te aritviti te dnyet  
 kolite mudi: dno: SWAN 3451  
 ecc. i dnyet. shetirime

Disa kolegë nga Prizreni janë shprehur se ishte një rast i mirë që mësimdhënësit e komunave të ndryshme të Kosovës qëndruan së bashku dhe shkëmbyen mendime lidhur me punën e tyre të përditshme. Shpresojmë që të gjithë kolegët tanë të kenë fat si ne.

Në mesin e kolegëve shqiptar kishte edhe kolegë të komunitetit boshnjak. Edhe ata u ndanë shumë të kënaqur me organizimin dhe vendin e mrekullueshëm siç është Durrësi. Edhe ata përmes librit të përshtypjeve, kanë shprehur mbresat e tyre për këtë pushim.

MOJ UTISAK SA ODMORA  
 KOBA JE ORGANIZOVANO  
 SBAŠKUKU  
 MENI JE VELIKO ZAHVALNO  
 LOSTVO ŠTO SAM IZABRAO  
 DA DOĐIJEM NA ODMORU  
 U NARODNOJ REP. ALBANIJI  
 U GRADU DURS KOJI IMA  
 EUROPSKU KULIZACIJU.  
 IZUZEJNO MI JE ZAHVALNO  
 ŠTO SAM UGRUŠTOU  
 SA SVIM PROSVETNIM RADN  
 CIMA REP. KOVOLO KOJI SU  
 MI VEOMA DRAGI KOJE POS  
 TUPJEM I KOJI ME POSLUŽUJ  
 KAO PRIPADNIKA ROŠNJAKO  
 ZAFONICE.  
 ODMOR ZA SVIŽUJE SUE POKU

POKUŠAVJEM OSOBIJE HOTELA  
 BENITA U DURS ZA LEPO  
 PONAŠANJE I GOSTOPRIMSTVO  
 UOČENO POKUŠAVJEM RUKOV  
 DSTVO ŠBAŠKUKU ZA LEPU  
 ORGANIZACIJU I DOBAR PRIMOJ

26. 06. 2015. Daut Yaceni  
 DURS

[illegible]

Implemented by:

Një koleg nga komuna e Deçanit ka thënë se janë gjeputa fjalët që thuhet se nuk është e mundur të takosh tërë Kosovën. Ai tha se ato ditë qëndrimi në Durrës na dhuruan mundësinë që të takojmë tërë Kosovën në një vend – *“Ishte një Kosovë në miniaturë. Ishte një mundësi që t’i lidhim tërë cepet e Kosovës, për krijimin e urave të miqësisë e bashkëpunimit”* – është shprehur z.Rexhep Maksutaj nga Isniqi.

- *“Një pushim i jashtëzakonshëm me bazë intelektuale që nuk e kisha përjetuar kurrë më parë”* – është shprehur z.Bekim Hyseni nga komuna e Vitisë.
- *“Mu dha mundësia që pas 38 viteve të vijë në plazh të Durrësit. Përshëndes të gjithë stafin e SBASHK-ut për organizimin e bukur që e kanë bërë.”* – ka shkruar në librin e përshtypjeve z.Ismet Mjeku nga komuna e Obiliqit.

- *“Kaluam ditë të bukura, mbrëmje gazmore, të paharruara që do të mbesin kujtime të pashlyera në sirtarin e jetës tonë”* – janë shprehur grupi i punonjësve të arsimit nga komuna e Gjakovës.

Kishte edhe kolegë të cilët gjatë qëndrimit në plazh shpalosën kujtime nga e kaluara e tyre – *“..përveç pushimit të këndshëm u njoftuam edhe me shumë shokë të gjeneratave tona dhe i përkujtuam ditët e shkollës së mesme, problemet dhe kënaqësitë që kaluam në ato ditë rinore dhe shpesh krahasuam atë kohë me të tanishmen.”* – kanë shkruar disa kolegë nga komuna e Suharekës.

Vërtet është një kënaqësi e madhe kur lexon fjalë të mira, merr lëvdata dhe lexon përshtypjet e kolegëve, ku në mesin e tyre kishte edhe disa që për herë të parë kishin vizituar plazhin.

## SBASHK-u vazhdon me takimet për dialog social Angazhime për realizimin e detyrave nga Plani strategjik



Duke realizuar agjendën e aktiviteteve në bazë të programit për vitin 2015, SBASHK-u organizoi në Durrës një punëtori disa ditore me anëtarët e Këshillit Drejtues, që përfaqësojnë të punësuarit në arsimin e Kosovës. Kryesia pa të udhës që në këtë punëtori të zhvillohen disa seanca pune duke veçuar çështje me rëndësi që lidhen me aktivitetet dhe sfidat e kësaj sindikate. Kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani dhe menaxheri i financave Ymer Ymeri në ditën e parë të kësaj punëtorie janë ndalur te Kontrata Kolektive për të parë çështjet konkrete e për të shikuar se cilat nga detyrat lidhen me dialogun social në nivel lokal e cilat me atë qendror.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani dhe menaxheri për financa Ymer Ymeri kanë shpalosur para Këshillit Drejtues pjesë të veçanta nga Strategjia duke kujtuar edhe për arritjet, sfidat dhe për detyrat që duhet kryer në shërbim të anëtarësisë. Pas kësaj të ndarë në grupe pune anëtarët e Këshillit Drejtues kanë dhënë propozime konkrete se për cilat çështje konkrete do të zhvillohet në shtator dialogu social me qeveritë lokale e për cilat me pushtetin qendror. Të gjithë janë zotuar se do të shtojnë angazhimet dhe do të vazhdojnë bashkëbisedat me anëtarësinë e SBASHK-ut me qëllim që t’i informojnë ata nga afër për gjithë aktivitetet dhe të marrin mendimin e tyre për veprimet konkrete.

Implemented by:



Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë veçuar disa nga pikat kyçe të Kontratës dhe kanë vlerësuar se cilat nga to janë për dialogun social në nivel lokal duke marrë kështu edhe obligime konkrete për ta , kryesitë dhe për Kuvendet e SAF e SAM në komunat e tyre. Ata janë obliguar që këto çështje t'i debatojnë edhe me kryetarët e shoqatave sindikale në shkollat e Kosovës dhe bashkërisht të angazhohen për realizimin e detyrave konkrete. Udhëtimi, tri pagat për mësimdhënësit e pensionuar, çështja e viteve 90-99, kushtet e punës, pjesëmarrja në panelet intervistuese

në cilësinë e vëzhguesit, janë vetëm disa nga çështjet që do të trajtohen gjatë dialogut me institucione të pushtetit lokal.



Një vëmendje e veçantë i është kushtuar në këto punëtori edhe detyrave konkrete që dalin nga Plani strategjik i SBASHK-ut për vitin 2015. Menaxheri i financave, Ymer Ymeri është ndalur të çështjet konkrete në këtë plan strategjik dhe përmes punës në grupe me gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues kanë krijuar një plan konkret të angazhimeve për muajt e mbetur të vitit 2015.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE  
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center  
Qendra për Arsimit dhe Shkencës në Kosovë

KEC

